

ORIENTUES PËR TË FILLUAR SHPEJT

Dhënia Mësim në Institut për Kurset Themeltare






PËRPARA MËSIMDHËNIES

- Studioni me kujdes hyrjen e materialit të mësuesit.
- Caktoni një kohë me bashkërenduesin ose drejtorin tuaj të institutit për të diskutuar mbi caktimin tuaj, studentët, kursin dhe çfarëdo pyetje që të keni.
- Lutuni për udhërrëfim që t'i ndihmoni studentët tuaj të vijnë te Krishti dhe të bëhen më shumë si Ai.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KURSET THEMELTARE

- Këto Kurse Themeltare janë hartuar që t'i ndihmojnë studentët të kenë përvoja kthimi në besim përpara, gjatë dhe pas diskutimit në orën mësimore.
- Secili mësim përbëhet si nga materiali i përgatitjes edhe nga materiali i mësuesit.
 - **Materiali i Përgatitjes:** hartuar që t'ju përgatitë për orën mësimore si ju edhe studentët tuaj, me informacion për rrethanat, shkrime të shenjta, mësim nga udhëheqësit e Kishës, nxitje që ftojnë nxenie më të thelluar, si dhe burime shtesë për studim të mëtejshëm.
 - **Materiali i mësuesit:** hartuar që t'ju ndihmojë t'i ftoni studentët ta tregojnë dhe ta diskutojnë atë që mësuan në përgatitjen e tyre, t'i ndihmoni ata ta thellojnë kuptueshmërinë dhe dëshminë e tyre për Zotin dhe ungjillin e Tij të rivendosur, si dhe t'i ftoni që të veprojnë.
- Jini të vetëdijshëm për rezultatet kyç që vijojnë të dëshirueshme për kursin teksa përqendrohni te përvojat e të mësuarit të studentëve dhe jo thjesht në zhvillimin e mësimëve.

PËRGATITJA	ANGAZHIMI	VEPRIMI
 <ul style="list-style-type: none">• Studentët dhe mësuesit përgatiten për orën mësimore nëpërmjet një përvoje përgatitjeje të orientuar.• Materiali i përgatitjes ndihmon për thellimin e studimit nga ana e studentëve dhe i përgatit ta tregojnë në orën mësimore atë që kanë mësuar.	 <ul style="list-style-type: none">• Mësuesit mbështeten te përgatitja e studentëve që t'i angazhojnë në shumë studentët në përvojën e të mësuarit dhe që t'i ndihmojnë ta thellojnë atë që mësojnë.• Përgatitja dhe përfshirja e studentëve lejon që të ketë më shumë kohë gjatë orës mësimore për të diskutuar dhe theksuar vënien në zbatim.	 <ul style="list-style-type: none">• Studentët ftohen që ta marrin parasysh mënyrën se si ta vënë në zbatim atë që kanë mësuar, dhe pastaj të veprojnë.• Theksimi i angzhimit dhe vënies në zbatim i ndihmon studentët në përpjekjet e tyre të qëllimta për t'u bërë më shumë si Ati Qiellor dhe Jezu Krishti.



PËRVOJA PROFESIONALE VIJUESE

- Ju do të keni mundësi të vazhdueshme me bashkërenduesin ose drejtorin tuaj të institutit për të diskutuar atë që po mësoni, për të bërë pyetje rreth caktimit tuaj, si dhe për t'u ushtruar për përmirësimin e mësimdhënies suaj.
- Ju mund t'i përdorni manualët dhe trajnimin e Seminarit dhe Institutit për t'u orientuar teksa mësoni parime dhe ushtroni aftësi që mund t'ju ndihmojnë të përmirësoheni si mësues/e.

